



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.23, datë 19.12.2024

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SUBJEKTI “JUANA” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik subjekti “Juana”, sipas Kontratës me Nr. 630 Rep., Nr. 190/1 Kol., datë 24.12.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentraleve “Orenjë Verri dhe Orenjë Katund” me kapacitet prodhues 1.370 MW, në përroin e Gurrës së Orenjes, Gurrës së Mushanes dhe Gurrës së Shterpaj, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan”
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC. Orenjë Verri

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Gurrë Shterpaj

- $X=518933$; $Y=4574997.9$; $Z=1298.32$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.15 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.075 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.013 \text{ m}^3/\text{s}$



Vendndodhja e veprës së marrjes 2/ burimi ujq Gurrë Mushanë

- $X=519136.8$; $Y=4573547.2$; $Z=1041.22$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.15 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.084 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.015 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=517936.5$; $Y=4572245.9$; $Z=795$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: $0.3 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 3.388.121 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 295 kwh

HEC. Orenjë Katund

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujq Gurrë Orenjë

- $X=517152.1$; $Y=4570985.1$; $Z=584$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.65 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.36 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.084 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=516508.1$; $Y=4570627.9$; $Z=492$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: $0.65 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 1.389.845 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 470 kwh

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

ALI MYSLIU

